



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2728/2 prot

Datë 08.11.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR, SI
DHE
LIDHUR ME PRETENDIMET PËR ANULIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshuar*”, me Nr. REF-83912-10-16-2023, me objekt: “Mirëmbajtje e sistemeve të parkimeve”, me fond limit 1,254,400 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 27.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit

Ankimues:

Operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, me NIPT M31904013D, me adresë: Rruba E Dibrës, Njësia Administrative Nr.8, Vila Nr,153, kati i parë, ZK nr.8360, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Fier
Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15.

Në datën 07.11.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3574, si dhe nr. protokollit 2728/2023 datë 07.11.2023 e operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-83912-10-16-2023, me objekt: “Mirëmbajtje e sistemeve të parkimeve”, me fond limit 1,254,400 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 27.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK në procedurën e prokurimit objekt ankimi, si dhe me anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime*” Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me numër ankimi elektronik elektronik A/2023/3574, si dhe nr. protokollit 2728/2023 datë 07.11.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës “QuantX IT Solution” SHPK, me NUIS M31904013D, konstatoi mangësit si më poshtë:

Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, në pikën 2.2.1, përcaktohet se:

”Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (2021, 2022) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se 400 000 lekë pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor...”

Operatori ekonomik “QuantX IT Solution” SHPK, në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur vetëm shkresën zyrtare nr.1265 prot., datë 19.10.2023, të Drejtorisë së Shërbimit të

Tatimpaguesëve, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, ku ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/shërbimeve për periudhën Janar-Shtator 2023. Pra, periudhë e cila nuk përputhet me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.2.1 të Shtojcës 8 të DST-së (të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (2021, 2022) lëshuar nga Administrata Tatimore), kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit", oferta e "QuantX IT Solution" SHPK skualifikohet.

Operatori ekonomik ankimues kërkon gjithashtu edhe anulimin e vendimit të AK për anulimin e e procedurës së mësipërme të prokurimit .

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 08.11.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

